

Njoftim

për plotësimin në sistem të pikëve mesatare (apo notave mesatare)

Plotësimin në sistem të pikëve mesatare (apo notave mesatare) do ta bëjnë:

1. Maturantët të cilët gëzojnë të drejtën të plotësojnë formularin A3 sipas Udhëzimit Nr. 27 datë 19.08.2015.
2. Përjashtohen nga ky detyrim ata maturantë të cilët kanë plotësuar formular A2 dhe dëshirojnë të vazhdojnë konkurrimin, meqenëse ata e kanë kryer këtë proces në periudhën kur u aplikua me formularin A2.

Plotësimi në sistem të pikëve mesatare (apo notave mesatare) do të bëhet pranë shkollave të mesme përkatëse në datat: 23.09.2015 – 28.09.2015 nga përfaqësuesit zyrtarë të këtyre shkollave. DAR/ZA-të të marrin masa për kontrollin e laboratorëve dhe monitorimin e procesit.

Theksojmë se secili maturant që gëzon të drejtën për plotësimin e formularit A3 dhe që dëshiron të konkurrojë në garën e pranimit në IALP (Institucionet e Arsimit të Lartë Publik) nëpërmjet **Parimit Meritë - Preferencë** në këtë raund, duhet së pari, pranë zyrave të Postës Shqiptare apo Bankave të nivelit të dytë të kryejë pagesën e tarifës së aplikimit të formularit A3 prej 2000 lekësh. Për të bërë të mundur kryerjen e kësaj pagese maturantët duhet të jenë të pajisur me Faturën për Arkëtim të cilën po ju a bashkëngjisim. Gjithashtu çdo maturant mund ta shkarkojë atë nga Web Site i Agjencisë Kombëtare të Provimeve: www.akp.gov.al në drejtimin:

Matura Shtetërore → Matura Shtetërore 2015 → Formulari A3

Me mandatin e pagesës për aplikim të formularit A3 si dhe me dokumentin identifikues (kartë identiteti, pasaportë biometrike ose certifikatë personale me fotografi, maturanti/kandidati paraqitet në shkollën e tij, e dorëzon atë dhe sigurohet që përfaqësuesja e shkollës të hedhë në sistem pikët apo notën mesatare të viteve të gjimnazit. Pas kryerjes së këtij procesi maturanti/kandidati ka të drejtën dhe mundësinë që të plotësojë online formularin A3 për Maturën Shtetërore 2015, në afatet e përcaktuara dhe publikuara nga MAS dhe AKP. Maturantët që nuk kanë shlyer pagesën përkatëse dhe për rrjedhojë nuk kanë të regjistruara në sistem pikët mesatare nuk lejohen nga sistemi informatik që të plotësojnë online formularin A3. E njëjta gjë do të ndodhë dhe për maturantët që rezultojnë mbetës në të paktën njërin prej provimeve të Maturës Shtetërore.

Agjencia Kombëtare e Provimeve